



RREGULLORE

“MBI ADMINISTRIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT”

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 06.06.2019

Në mbështetje të nenit 29 pika 3 dhe neneve 42 e vijues të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit”, me propozimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

Vendosi: Kreu I

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat e detyrueshme mbi administrimin e Fondit të Kompensimit dhe mbi delegimin, trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 2 Përcaktimi i Termave

Të gjithë termat e fushës mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit të përdoruar në këtë Rregullore kanë kuptimin e dhënë në Ligjin Nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit”.

Neni 3 E drejta e palës së dëmtuar dhe ndarja e dëmeve të rrjedhura nga Fondi Kompensimit për efekt të administrimit dhe trajtimit të tyre

3.1 Pala e dëmtuar e cila është dëmtuar brenda territorit të Republikës të Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga Byroja në rastet kur:

- Dëmi është shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik të pasiguruar;
- Dëmi është shkaktuar nga përdorimi i mjeteve motorike të paidentifikuara;
- Siguruesi përgjegjës i mjetit motorik shkaktar të aksidentit bazuar në një vendim ligjor të vlefshëm ndërpret veprimtarinë dhe/ose falimenton;
- Dëmi i pësuar nga pasagjeri në mjetin e transportit publik të pasiguruar me kontratën e sigurimit nga aksidentet të pasagjerëve në transportin publik.

3.2 Praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për efekt të trajtimit, pagesës dhe rimbursimit ndahen në:

1. Dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara të cilat trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga shoqëria e sigurimit, anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për llogari të Fondit të Kompensimit;
2. Dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara dhe/ose të pidentifikuara, trajtimi, pagesa dhe rimbursimi i të cilave administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, sipas parashikimeve në këtë rregullore.

Për vërtetimin nëse mjete motorik është i siguruar ose jo merret konfirmimi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Në rast se vërtetohet në të ardhmen se mjete motorik shkaktar i aksidentit është i siguruar, dëmi i paguar ose në proces pagese nga Fondi i Kompensimit do të mbulohet nga shoqëria e sigurimit që ka lëshuar kontratën e sigurimit të detyrueshëm.

Kreu II

GRUPI I

Neni 4

Dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara të cilat trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga shoqëria e sigurimit, anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për llogari të Fondit të Kompensimit

Shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të Byrosë Shqiptare të Sigurimit trajton, paguan dëmin dhe rimbursos shumën e paguar, që rrjedh apo shkaktohet nga mjete motorike të pasiguruara sipas rasteve të përcaktuara më poshtë:

- a. Dëmet materiale të shkaktuara një mjete motorik të siguruar nga mjete të pasiguruara të identifikuara, dëmi i shkaktuar paguhet nga shoqëria e sigurimit ku pala e tretë e dëmtuar (mjete motorik) është e siguruar;
- b. Dëme shëndetësore të pësura nga pasagjeri në mjetin motorik të dëmtuar, dëmi i shkaktuar të paguhet nga shoqëria e sigurimit ku pala e tretë e dëmtuar (mjete motorik) është e siguruar;
- c. Dëme shëndetësore të pësura nga pasagjerët në mjetin motorik të pasiguar shkaktar i aksidentit, me një mjet motorik të siguruar, dëmi i shkaktuar të paguhet nga shoqëria e sigurimit ku pala e tretë e dëmtuar (mjete motorik) është e siguruar.

(Shembull)

4.1/a: Drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB i pasiguar, shkaktar i aksidentit, dëmton mjetin me targë AA 234 AB, i siguruar pranë shoqërisë së sigurimeve X. Shoqëria e sigurimit X, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (pronarin e mjetit me targë AA 234 AB, i siguruar pranë saj) për dëmet materiale që i janë shkaktuar mjetit të tij nga mjete të pasiguar me targë AA 123 AB.

4.1/b: Drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB i pasiguar, shkaktar i aksidentit, dëmton drejtuesin/pasagjerët që udhëtojnë në mjetin me targë AA 234 AB, i siguruar pranë shoqërisë së sigurimeve X. Shoqëria e sigurimit X, dëmshpërblen palën e tretë të

dëmtuar (drejtuesin/pasagjerët që udhëtonin në mjetin me targë AA 234 AB, i siguruar pranë saj) për demet shëndetësore që i janë shkaktuar atyre nga mjete të pasiguruar me targë AA 123 AB.

4.1/c: Drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB i pasiguruar, shkaktar i aksidentit, dëmton pasagjerët që udhëtojnë në mjetin e drejtuar prej tij gjatë aksidentit me mjetin motorik me targë AA 234 AB, i siguruar pranë shoqërisë së sigurimeve X. Shoqëria e sigurimit X, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (pasagjerët që udhëtonin në mjetin me targë AA 123 AB i pasiguruar, shkaktar aksidenti) për demet shëndetësore që i janë shkaktuar atyre nga mjete të pasiguruar me targë AA 123 AB, ku ata udhëtonin si pasagjerë.

4.1/ a/b/c: Në rastin kur kemi dy ose më shumë mjete të dëmtuara të siguruara, demet materiale dhe/ose shëndetësore sipas pikave a), b) dhe c) më lart, trajtohen, paguhen dhe rimburohen nga shoqëria siguroese e secilit mjet të dëmtuar.

Neni 5

Pagesa e dëmeve nga shoqëria e sigurimit

5.1 Trajtimi, Pagesa dhe Rimbursimi i pagesave të dëmeve për rastet e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje kryhen drejtpërdrejt nga vetë shoqëria e sigurimit, deleguar nëpërmjet kësaj rregulloreje pa pasur nevojë për akt delegimi të veçantë, duke raportuar në Byro sipas parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje.

5.2 Procedura, afatet dhe raportimi që ndiqet nga shoqëria e sigurimit lidhur me trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e dëmit të paguar është e njëjtë me procedurat, afatet dhe raportimin e trajtimit të dëmeve të rrjedhura nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm TPL dhe Kufitare bazuar në Ligjin 10076, datë 12.02.2009 dhe Rregulloren nr. 53 të vitit 2009 të Autoritetit.

5.3 Autoriteti monitoron dhe ushtron kontrollin përkatës mbi shoqërinë e sigurimit për respektimin e kërkesave ligjore në trajtimin, pagesën dhe rimbursimin sipas kësaj rregulloreje, në të njëjtën mënyrë siç ushtron monitorimin apo kontrollin për trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm MTPL dhe Kufitare.

Kreu III

GRUPI II

Neni 6

Dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara dhe/ose të paidentifikuara, trajtimi, pagesa dhe rimbursimi i të cilave administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit

6.1 Dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara dhe/ose të paidentifikuara, trajtimi, pagesa dhe rimbursimi i të cilave administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit janë rastet si më poshtë:

- a. Dëme shëndetësore të shkaktuara nga mjete motorik i paidentifikuar, bazuar në vendimin e prokurorisë dhe/ose të gjykatës të formës së prerë;
- b. Dëme të shkaktuar pasagjerit në mjetin motorik të pasiguruar shkaktar i dëmit, kur nuk aksidentohet me një mjet tjetër motorik;
- c. Dëme të shkaktuar palëve të dëmtuara dhe pasagjerit në mjetin motorik të pasiguruar shkaktar i dëmit kur aksidentohet me një mjet tjetër motorik të pasiguruar;
- d. Dëmet të shkaktuara kalimtarit/këmbësorit në rrugë nga mjet motorik i pasiguruar shkaktar të dëmit;
- e. Dëme pasurore (materiale) i shkaktuar në rrugë nga mjet motorik i pasiguruar shkaktar të dëmit;
- f. Dëme motorike të shkaktuara nga një mjet i paidentifikuar apo pasiguruar ndaj një mjeti të transportit publik me një numër pasagjerësh jo me pak se 8+1 vende në kuptim të nenit 17 të Ligjit 10076.
- g. Siguruesi përgjegjës i mjetit motorik shkaktar të aksidentit bazuar në një vendim ligjor të vlefshëm ndërpret veprimtarinë dhe/ose falimenton.

(Shembull)

6.1/d: Në aksidentin e datës 01/01/2011, gjatë përplasjes me një mjet të paidentifikuar i cilësuar shkaktar i aksidentit me vendim gjyqësor të formës së prerë, është dëmtuar drejtuesi L.K dhe pasagjerët I.M dhe B.N që udhëtonin në mjetin motorik me targe AA 123 AB dhe kalimtari M.L. Bazuar në vendimin e prokurorisë dhe/ose vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, nuk është bërë i mundur identifikimi i mjetit shkaktar apo i drejtuesit të tij. Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe/ose shoqëria e sigurimit e autorizuar nëpërmjet Fondit të Kompensimit, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (drejtuesin L.K, pasagjerët I.M dhe B.N dhe kalimtari M.L) për dëmet shëndetësore që i janë shkaktuar palëve të treta të cituara më sipër nga një mjet i paidentifikuar.

6.1/e: Me datë 01/01/2011, pasi humbet kontrollin e mjetit, drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB, i pasiguruar, bie në kanal. Në këtë mjet udhëtonin si pasagjer shtetasit M.L dhe T.B të cilët si pasojë e aksidentit pësuan dëmtime në shëndetin e tyre. Byroja Shqiptare e Sigurimit nëpërmjet Fondit të Kompensimit, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (pasagjerët M.L dhe T.B) për dëmet shëndetësore që i janë shkaktuar atyre gjatë udhëtimit si pasagjer në mjetin me targë AA 123 AB, i pasiguruar, shkaktar i aksidentit.

6.1/f: Me datë 01/01/2011, mjeti me targë AA 123 AB, i pasiguruar, përplasjet me mjetin me targë AA 234 AB i pasiguruar. Bazuar në Vendimin penal të formës së prerë, shkaktar i aksidentit është drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB. Në këtë mjet (mjetin shkaktar të aksidentit) udhëtonin si pasagjerë shtetasit B. I dhe L.M, të cilët si pasojë e aksidentit pësuan dëmtime në shëndetin e tyre. Byroja Shqiptare e Sigurimit nëpërmjet Fondit të Kompensimit, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (shtetasit B. I dhe L.M) për dëmet shëndetësore që i janë shkaktuar atyre gjatë udhëtimit si pasagjer në mjetin me targë AA 123 AB, i pasiguruar, shkaktar i aksidentit.

6.1/g: Me datë 01/01/2011, drejtuesi i mjetit me targë AA 123 AB, i pasiguruar, përplas kalimtarin B.L, i cili si pasojë e përplasjes pëson dëme në shëndetin e tij. Bazuar në vendimin penal të formës së prerë, shkaktar i aksidentit ka rezultuar drejtuesi i mjetit

me targë AA 123 AB, i pasiguruar. Byroja Shqiptare e Sigurimit nëpërmjet Fondit të Kompensimit, dëmshpërblen palën e tretë të dëmtuar (kalimtarin B. L) për dëmet shëndetësore që i janë shkaktuar atij gjatë kalimit të rrugës nga mjeti me targë AA 123 AB, i pasiguruar, shkaktar i aksidentit. I njëjti rast është dhe për dëmet pasurore (materiale) të shkaktuar objekteve në rrugë.

Neni 7

Krijimi, Llogaritja dhe Financimi i Fondit të Kompensimit

7.1 Fondi i Kompensimit, i nevojshëm për trajtimin dhe pagesën e dëmeve për rastet e parashikuara në këtë rregullore, administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve dhe përbëhet nga:

- a. Kontributi i përvitshëm i çdo shoqërie sigurimi anëtare të Byrosë sipas përcaktimeve të ligjit për sigurimin e detyrueshëm;
- b. Burime të tjera të parashikuara në nenin 45, pika 3 të Ligjit Nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit”.

7.2 Kontributi vjetor i çdo shoqërie sigurimi llogaritet për çdo vit nga Byroja në përpjesëtim të drejtë me primet bruto, të shkruara në sigurimin e detyrueshëm, në vitin paraardhës.

7.3 Baza e të dhënave për llogaritjen e kontributit të shoqërive të sigurimit do të jenë primet bruto, të shkruara për sigurimet e detyrueshme të përgjegjësishë së mbajtësit të një mjeti motorik me mbulim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të 10 muorit të vitit paraardhës të marra zyrtarisht nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe parashikimit 2 muor të çdo shoqërie sigurimi. Afatet, procedura e financimit dhe axhustimi i Fondit të Kompensimit do të bëhet në përputhje me parashikimet e Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për standartet e raportimit dhe mbikëqyrjes të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”

7.4 Byroja, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, brenda datës 30 nëntor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, vlerën e kontributit në Fondin e Kompensimit për vitin e ardhshëm kalendarik.

7.5 Me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë dhe me miratim të Autoritetit, shoqëritë e sigurimit financojnë shtesë të Fondit të Kompensimit në rastet kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat. Shtesa e Fondit të Kompensimit llogaritet në të njëjtin raport që zë çdo anëtar i Byrosë në Fondin e Kompensimit për vitin ushtrimor.

7.6 Pas miratimit nga AMF të shumës së kontributeve në Fondin e Kompensimit Byroja njofton shoqëritë e sigurimit për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

7.7 Çdo shoqëri sigurimi llogarit çdo fillim 3-mujori të çdo viti kalendarik shumën që i korrespondon kontributit të saj në fondin e kompensimit për 3 mujorin përkatës të vitit në fjalë, fond i cili do të përdoret për pagesën e dëmeve të rrjedhura nga Fondi Kompensimit të parashikuara në nenin 4 dhe 6 të kësaj rregulloreje. Shoqëritë krijojnë llogaritë qëllimore për Fondin e Kompensimit, të cilat do të shërbejnë për pagesën e dëmeve të Fondit të Kompensimit.

7.8 Byroja njofton Autoritetin menjëherë, nëse shoqëria e sigurimit anëtare e saj, nuk përmbush detyrimet për financimin e Fondit të Kompensimit, në masën, mënyrat dhe afatet e parashikuara në këtë rregullore.

7.9 Autoriteti, me njoftimin e Byrosë sipas pikës 7.8 me lart, ka të drejtë të ndërmarrë sanksionet e parashikuara në ligj ndaj shoqërisë së sigurimit e cila nuk ka përmbushur detyrimet për pagesat e dëmeve të Fondit të Kompensimit.

Neni 8

Rezerva mbi Fondin e Kompensimit

8.1 Rezerva mbi Fondin e Kompensimit është rezerva që krijohet, për llogari të Fondit të Kompensimit dhe për të siguruar financimin e këtij të fundit.

8.2 Byroja llogarit Rezervën mbi Fondin e Kompensimit dhe njofton me shkresë çdo shoqëri sigurimi për vlerën që duhet të mbajë si Rezervë mbi Fondin e Kompensimit. Me marrjen e njoftimit nga Byroja, çdo shoqëri sigurimi është e detyruar të mbajë Rezervën mbi Fondin e Kompensimit.

8.3 Në rast se Fondi i Kompensimit i parashikuar për vitin kalendarik rezulton i pamjaftueshëm për të kryer pagesat, shoqëritë e sigurimit financojnë shtesë të Fondit të Kompensimit. Shtesa e Fondit të Kompensimit llogaritet në të njëjtin raport që zë çdo Anëtar i Byrosë në Fondin e Kompensimit për vitin ushtrimor. Asambleja e Përgjithshme e Anëtareve miraton shumën e kontributit shtesë për çdo shoqëri sigurimi anëtarë të Byrosë dhe njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të gjithë anëtarët rifinancojnë shtesën nga Rezerva mbi Fondin e Kompensimit.

8.4 Autoriteti mbikëqyr zbatimin e rifinancimit të shtesës nga shoqëritë e sigurimit anëtarë të Byrosë. Shoqëritë e sigurimit që nuk rifinancojnë shtesën e Fondit të Kompensimit bëhen subjekt i masave administrative të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 9

Administrimi i dëmeve të rrjedhura nga Fondi i Kompensimit

9.1 Byroja krijon programin e sistemit unik të numërtimit të praktikave Fond Kompensimi.

9.2 Anëtarët për çdo rast raportojnë në Byro dhe kjo e fundit brenda datës 30 të çdo muaji i dërgon të gjithë anëtarëve një evidencë analitike për dëmet të paguara nga Fondi i Kompensimit të parashikuar në nenin 4 dhe 6 të rregullores si dhe evidencën përmbledhëse mbi dëmet pezull të ndara këto në dëme materiale dhe shëndetësore. Mbajtja dhe raportimi mbahet i ndarë sipas grupeve.

9.3 Byroja, çdo tre muaj, bën rakordimin midis pagesave të kryera dhe detyrimit përkatës të çdo shoqërie sigurimi për Fondin e Kompensimit dhe informon anëtarët lidhur me administrimin, financimin, gjendjen në fund të tremujorit dhe nevojat për fond shtesë.

Neni 10

Mënyra, procedurat dhe afatet e trajtimit, pagesës dhe rimbursimit të dëmeve të rrjedhura nga Fondi i Kompensimit të parashikuar në nenin 6

10.1 Byroja mund t'ia delegojë trajtimin dhe/ose pagesën e dëmeve dhe rimbursimin e dëmeve të paguara që rrjedhin nga Fondi i Kompensimit sipas rasteve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje shoqërive të sigurimit anëtare të saj. Shoqëritë e sigurimit do të jenë të detyruara të trajtojnë dhe të paguajnë dëmin nga Fondi i Kompensimit për rastet e parashikuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje. Duke qenë se shoqëria e sigurimit trajton dhe paguan dëme nga llogaria e Fondit të Kompensimit, shoqëria e sigurimit trajton dhe/ose paguan dëme deri në limitin e miratuar si Fond Kompensimi për vitin kalendarik. Byroja nëpërmjet shoqërive të sigurimit anëtare financojnë shtesë të Fondit të Kompensimit në rastet kur Fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat sipas përcaktimeve të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Për rastet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit të parashikuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje, për trajtimin e rasteve bëhet shpërndarja nga Byroja sipas sistemit të rotacionit ndërmjet të gjitha shoqërive të sigurimit anëtarë të saj duke filluar nga shoqëria e sigurimit që zotëron në vitin paraardhës përqindjen më të madhe në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike.

10.2 Praktikrat e dëmeve objekt Fond Kompensimi, pas kompletimit me dokumentacionin e duhur ligjor dhe trajtimit në përputhje me rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 të AMF-së dhe Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, dërgohen nga shoqëria trajtuese për miratim në Komisionin e Trajtimit të Dëmeve pranë Byrosë. Çdo praktike dëmi duhet të këtë detyrimisht deklaratën e shkaktarit të dëmit për vënien në dijeni për vlerën e dëmit kur ky jeton edhe ka zotësi juridike për të vepruar në të kundërt merret dosja në organet kompetente (Prokuroria) ose shënimin përkatës kur ka refuzuar firmosjen e deklaratës.

10.3 Me miratimin e praktikës nga Komisioni i Trajtimit të Dëmeve, Byroja ofron dhe paguan dëmin sipas afateve ligjore ose në rast delegimi për pagesë brenda 5 ditëve kalendarike dërgon pranë shoqërisë së sigurimit vendimin e Komisionit të Trajtimit të Dëmeve, fotokopje të dokumentacionit të praktikës dhe autorizimin për pagesën, dhe shoqëria e sigurimit ekzekuton pagesën, në favor të palës së dëmtuar brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e dokumentacionit. Vërtetimi i pagesës (vërtetimi bankar), urdhri përkatës për pagesë, fotokopje e kartës së identitetit të përfituesit dhe i deklaratës së pranimit të vlerës së dëmshpërblimit i dërgohet Byrosë. Shoqëria e sigurimit gjithashtu fillon procedurat ligjore për rimbursimin e dëmit nga shkaktari.

10.4 Në qoftë se Byroja Shqiptare nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të Fondit të Kompensimit tek shoqëritë e sigurimit anëtare të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre, shpërndarja për pagesë tek shoqëritë e sigurimit, do të bëhet nga vetë Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare.

Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës tek shoqëria e sigurimit e caktuar nga Autoriteti.

Kjo procedurë do të ndiqet dhe në rastet kur shoqëritë e sigurimit kthejnë në Byro praktika të Fondit të Kompensimit për të cilat janë deleguar nga BSHS"

10.5 Shoqëritë e sigurimit mund të rimbursojnë në rrugë jashtëgjyqësore vlerat e dëmeve të paguara, dhe mund të negociojnë për vlerat e dëmshpërblimeve edhe në rastet kur është miratuar një vlerë nga komisionet përkatëse. Në këto raste, shoqëria e sigurimit njofton Byronë dhe dërgon dokumentacionin përkatës si marrëveshja mes palëve të noterizuar, për uljen e vlerës, etj. Byroja regjistron në librat kontabël vlerën e re të rënë dakord mes palëve.

10.6 Çdo shoqëri sigurimi që ekzekuton një rimbursim njofton menjëherë Byronë e cila rakordon dhe bën regjistrimet përkatëse.

10.7 Për trajtimin e dëmeve çdo shoqëri sigurimi përfiton një tarife trajtimi në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë për dosje të trajtuar. Kjo vlerë zbritet nga Fondi i Kompensimit.

10.8 Pagesa e dëmeve, objekt Fond Kompensimi të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje, kryhet nga Byroja dhe/ose nga shoqëria e sigurimit në rast delegimi, sipas kësaj rregulloreje, në përputhje me rregulloren nr. 53, datë 25.06.2006 të AMF-së dhe Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, si dhe udhëzimeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë.

10.9 Pagesa e dëmshpërblimit nga Fondi i Kompensimit bëhet vetëm për shuma, për të cilat i dëmtuari nuk ka mundësi të përfitojë nga sigurimet shoqërore ose nga ndonjë sigures tjetër, me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë sigurimi për të përfituar dëmshpërblim dhe brenda kufijve të përcaktuar në Ligjin nr. 10076, datë. 12.02.2009.

Neni 11

Fondi i Kompensimit në mbyllje të vitit financiar

11.1 Byroja në fund të çdo periudhe financiare (31 Dhjetor) harton bilancin e Fondit të Kompensimit për rastet e parashikuara në nenin 4 dhe në nenin 6 të kësaj rregulloreje të ndarë, pasqyra e kontributeve dhe pagesave të tij.

11.2 Në fund të çdo vit financiar (gjendja financiare si me 31 dhjetor) Fondi i Kompensimit duhet të mbyllet teorikisht. Tepricat në llogaritë e Fondit të Kompensimit si me datë 31 dhjetor të çdo viti, do të pasqyrohen në bilancin e Byrosë si detyrime financiare ndaj shoqërive të sigurimit në raport me përqindjet që ato kanë kontribuar në Fondin e Kompensimit për vitin financiar në fjalë. Në fillim të vitit financiar pasues Byroja do të autorizojë njohjen e këtyre detyrimeve si pjesë e kontributit të shoqërive të sigurimit në Fondin e Kompensimit për këtë vit pasues e llogaritur kjo në raport me përqindjen e kontributit që i përket çdo shoqërie sigurimi për këtë vit financiar.

11.3 Byroja, brenda datës 15 janar të çdo viti i dërgon shoqërisë së sigurimit përkatëse, të gjitha praktikatat e dëmit të cilat janë miratuar por nuk janë paguara deri më datë 31.12. të çdo fund viti së bashku me vendimin e marrë nga komisioni i trajtimit të

dëmeve dhe autorizimin për pagese. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të ekzekutojë pagesën, në favor të palës së dëmtuar brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Kreu IV

Neni 12

Rimbursimi i dëmeve të Paguara nga shkaktarët e pasiguruar dhe arkëtimi i tyre

12.1 Rimbursimi i pagesave Fond Kompensimi për dëmet e shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara, të parashikuara në nenin 4 të rregullores, si dhe ato të trajtuara dhe paguara me delegim të BSHS parashikuar në nenin 6, bëhet nga shoqëria sigurorese që ka paguar dëmin.

12.2. Arkëtimet e realizuara nga vetë Byroja nga padite e kthimit (regresit) i shpërndahen anëtarëve në raport me përqindjen që zinte çdo anëtar në Fondin e Kompensimit në vitin në të cilin është paguar dëmi.

Neni 13

Procedura e ndjekjes së rimbursimit

13.1 Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe/ose shoqëria e sigurimit sipas rasteve të parashikuara në nenin 4 dhe 6 të kësaj rregulloreje procedon me pagesën e dëmit në favor të palës së dëmtuar pasi ka kryer veprimet e mëposhtme:

- a. Njoftimi formal i shkaktarit për detyrimin e tij për pagese;
- b. Vënia në dijeni për vlerën e përlllogaritur të dëmit të cilin ai duhet të paguajë;
- c. Vënia në dijeni dhe dhënia e mundësisë shkaktarit të dëmit për ta zgjidhur çështjen direkt me palën e dëmtuar pa përfshirë Fondin e Kompensimit;
- d. Nënshkrimi i deklaratës nga shkaktari i dëmit sipas formatit bashkëlidhur që njihet dhe është dakord me vlerën e dëmit të përlllogaritur. Në rast se refuzon firmën bëhet shënimi përkatës në deklaratë;

13.2 Kushtet dhe procedura e përcaktuar në pikën 13.1 asnjëherë nuk duhet të jetë pengesë për procedurën e dëmshpërblimit kundrejt palëve të treta apo të shkelë afatet ligjore të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim.

Kreu V

Neni 14

Dispozita te fundit

14.1 Regjistrimi në Byro për dëmet e parashikuara në nenin 4 dhe nenin 6 të kësaj rregulloreje, bëhet për të gjitha rastet dhe evidentohet i ndarë.

14.2 Fondi dhe pagesat e dëmeve të përcaktuara në nenin 4 dhe 6 të kësaj rregulloreje të fillojë të zbatohet për të gjitha praktikatat me datë aksidentit duke filluar nga 1 janar 2014 e në vazhdim.

14.3 Për dëmet pezull të paraportuara dhe/ose të miratuara e të papaguara me datë aksidenti deri me datë 31 dhjetor 2013 të trajtohen dhe paguhen nga Fondi i

Kompensimit sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore. Këto dëme i ndahen shoqërive të sigurimit si më poshtë:

- a. Për rastet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje praktikat e dëmeve i kalojnë shoqërive të sigurimit respektive;
- b. Për rastet e përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje sipas vendimit të delegimit, i shpërndahen shoqërive të sigurimit sipas sistemit të rotacionit ndërmjet të gjitha shoqërive të sigurimit anëtarë të saj duke filluar nga shoqëria e sigurimit që zotëron vitin paraardhës përqindjen më të madhe në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike.

14.4 Detyrimi për afatet të përcaktuara në pikat 10.3 dhe 10.4 të nenit 10 të kësaj rregulloreje duhet të zbatohet dhe për të gjitha rastet e dëmeve të cilat kanë përfunduar (miratuar ose me vendim të formës së prerë) me ngjarje siguri deri 31.12.2013.

14.5 Dëmet e paguara dhe të regesuara deri më 31.12.2013 i shpërndahen anëtarëve të Byrosë, në raport me % (përqindjen) e kontributit që ka pasur secila shoqëri siguri në vitin që është paguar dëmi. Detyrimet e regesuara pas datës 31.12.2013 i kalojnë në llogarinë e shoqërisë sigurimeve që ka kryer procedurat e regresit.

14.6 Byroja Shqiptare e Sigurimit të njoftojë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për këtë rregullore dhe ndjekjen e procedurave

Neni 15 Sanksione

Në rast se një anëtar nuk zbaton detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore, Byroja njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për vendosjen e sanksioneve sipas legjislacionit në fuqi.

Rregullorja nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, shfuqizohet.

DEKLARATE

E nënshkruar sot me date ___/___/201__ (dymijë e _____), në _____:

Unë, i nënshkruari _____, i biri i _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. _____,

Deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore, duke qene i njohur me pasojat ligjore që sjell një deklaram i rreme se:

Më datën _____ gjatë drejtimit të mjetit me targë _____ jam përfshirë në një aksident automobilistik ku u dëmtua mjete me targë/ose u dëmtua Z./Znj. _____. Në momentin e ndodhjes së aksidentit unë kam qenë i papajisur me policën e sigurimit të detyrueshëm. Në këto kushte bazuar ne ligjin “Mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, kuptoj dhe pranoj se përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës _____ jam unë i nënshkruari _____.

Deklaroj se jam vene ne dijeni te detyrimit qe kam përkundrejt Z./Znj. _____ dhe nuk/jam plotësisht dakord të shlyejë dëmin në vlerën prej _____ (_____).

Deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se vlera prej _____ (_____) është vlera reale dhe e plotë e dëmshpërblimit, bazuar në ligjin nr. 10076 date 12/02/2012 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Pasi e lexova dhe jam plotësisht dakord me atë çfarë unë vete kam deklaruar më sipër, duke mos qenë nën dhunë, mashtrim, kanosje, nevojë apo lajthim e firmos këtë deklaram me vullnet të lirë.

Kjo deklaram u përpilua në dy kopje origjinale, ku një të kopje e mora unë Deklaruesi dhe kopja tjetër mbahet në dosjen e dëmit.

DEKLARUESI
